

INFORMACIONI PER NDERVEPRIMINME MJEDISIN

**SHFRYTEZIMI I GELQEROEREVE TE MERMERIZUAR,
ZONA MINERARE KONKURUESE NR 349/2,
KANINE-VLORE.**

(Sipas Ligjit nr.10 440 date 07.07.2011 "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis" Kodi eshte 19)



Porositi: Shoqeria "Beauty of Albania" sh.p.k

Punoi: Comercir Studio

Shtator 2018



TABELA PERMBLEDHESE

1. Nje pershkrim te shkurter te mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet projekti te shoqeruar me imazhe te marra jo me vone se 6 muaj nga data e aplikimit
2. Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te saj .
3. Nje indentifikim te ndikimeve te mundeshme negative ne mjedis te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet,uje,toke,ajer;
4. Nje pershkrim te shkurter per shkarkimet e mundeshme ne mjedis, te tilla si: ujra te ndotura,gaze dhe pluhur,zhurme,si dhe prodhimin e mbetjeve;
5. Informacion per kohezgjatjen e mundeshme te ndikimeve negative te indentifikuara
6. Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesine te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara qeperfshihen ne te.
7. Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit tesiperfaqes te mjedisit te ndikuar ne gjendin e meparshme ,perfshire edhe token bujqesore,si dhe kostot financiare te peraferta per per rehabilitimin.
8. Masat e mundeshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negativene mjedis. .
9. Ndikimet e mundeshme ne mjedisin nderkufitar(nese projekti ka natyre te tille.)

Hyrje.

Informacioni per nderveprimin me mjedisin te projektit hartohet ne zbatim te vendimit Nr. 686 nr. 29.07.2015 "Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit te Deklarates Mjedisore".

Subjekti " **Beauty of Albania**" sh.p.k ka marre pjese ne konkurimin e zhvilluar me 28.05.2018 per perfitimin e te drejtes per aplikim per Leje Minerare shfrytezimi per zonen minerare 349/2 dhe ne daten 19/07/2018 me shkresen me Nr 10084/3 Prot eshte njoftuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, Drejtoria e Programeve te Zhvillimit te Industrise dhe Energjise, si fitues i ketij konkurime dhe ka fituar te drejten e pergatitjes se dokumentave perkatese per pajisjen me leje minerare shfrytezimi ne zonen konkuruese Nr 349/2

1. Nje pershkrim te shkurter te mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet projekti te shoqeruar me imazhe te marra jo me vone se 6 muaj nga data e aplikimit

Vendi ku kerkohet leja e shfrytezimit eshte pothuajse i zhveshur nga bimesia. Rriten vetem pak shkurre te vogla loka me dendesi dhe permasa te pakonsiderueshme . Ne zonen e dherave (mbuleses qe nuk perfaqeson rezerva gjeologjike argjilore) rriten lule dhe barishte karakteristike te zones . Ne pjesen nen zonen e shfrytezimit rritet shkure, qe jane karakteristike per kete zone (Foto) .Prania e tyre vihet re kryesisht ne pjeset me depozitime karsite qe lokalizohen ne perendim te zones.



Foto. Pamje e pjese se siperme te objektit pa bimesi

2. Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te saj .

Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk vihen re burime natyrale ujrash. Pikerisht ne vendin ku kerkohej leja minerare nuk ka prroska. Kur ka reshje, neper te rrjedhin ujra siperfaqesore per shkak dhe te pjerresise jo mjaft te madhe te terrenit.

3. Nje indetifikim te ndikimeve te mundeshme negative ne mjedis te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet,uje,toke,ajer;

• **Humbje e tokes per kullote**

Zona, ku do te kryhet aktiviteti minerar, eshte nje zone qe shfrytezimi fillon rishtaz. Kjo zone ka mbi siperfaqen e saj bar te rralle. Siperfaqja e objektit eshte pothuajse masiv shkembor dhe nuk ka pase mundesi te zhvillohet bimesi. Tek tuk rriten shkure, por ne te gjithe siperfaqen qe planifikohet per shfrytezim, nuk ndodhet asnje lloj peme e kultivuar apo natyrale . Siperfaqja e planifikuar per shfrytezim nuk eshte toke bujqesore apo kullote

• **Humbje e pjerresise se tokes**

Zona, ku do te kryhet shfrytezimi, nuk do te ndryshoje pjerresine ne perfundim te shfrytezimit. Germimi eshte parshikuar te behet ne nje thellesi te vogel dhe me nje kend shuarje te karirres gati te barabarte ne ate te terenit. Mbushja vit pas viti e siperfaqes se shfrytezuar dhe sistemimi do krijojte mundesine e mbjelljes se drureve pyjore dhe ndryshimin e permiresimin e peisazhit te prishur.

Shfrytezimi nuk do te shkaktojte humbje te pjerresise se tokes dhe nuk do te favorizojte erozionin e saj.

• **Ndotja e tokes nga rrjedhjet**

Ne projektin e shfrytezimit jane percaktuar masa si pjerresite e shesheve te punes, kanalet e ndryshme ne ane te rruges etj te cilat do te mundesojne dekantimi llumrave te pakta ne ujra brenda kufijve te shfrytezimit . Ne stinen e thate keto dekantime do te ngarkohen dhe transportohen ne vendin e depozitimit te dherave .

• **Ndotja e tokes nga mbetjet e ngurta**

Nga kryerja e aktivitetit minerar per shfrytezimin e gelqeroreve, mbetjet e ngurta do te jene mbulesa vegjetale dhe copa gelqerori. Keto mbetje do te vendosen ne sheshet e brezave te sigurimit, dhe ne horizontet +400m dhe +550 m te sejciles karriere, si ne siperfaqen e lene per kete qellim Ne keto horizonte per vendosjen e sasise se sterilit, qe do te dale gjate shfrytezimit do te krijohet nje trashesi prej rreth 10-12m, ndersa hapësira e shfrytezimit e lejon edhe per me shume.

Ato perfaqesohen nga deluvione te shkriфта dhe copra shkembore qe nuk permbajne elemente ndotes per ambientin. Keto depozitime jane fertile dhe do te sherbejne me se miri per rigjenerimin e karrieres.

• **Ndotja e tokes nga depozitimi i llumrave**

Gjate shfrytezimit te objektit nuk parashikohet depozitime llumrash . Ato, qe ne sasi shume te pakta do te krijohen gjate rreshjeve do te depozitohen brenda karrieres dhe do te riperdoren ne rigjenerimin e saj